



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.173/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 26.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Refuzohet e pabazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.173/2025, e datës;24.01.2025 paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Me datë;24.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV),me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë identifikuar se më datë 23 janar 2025, janë vendosur postera në hapësirë publike, konkretisht në ndërtesë të banimit kolektiv, në Rrugën “ 18 Qershori” të kandidatit për deputet Xhevahir Geci, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Tutje në ankesë theksohet se ky veprim i subjektit politik PDK, është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës -LZP-së. Ku theksohet se sipas nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së, parashihet se: “1.2. vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve. Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP-në.

PZAP, me datë 25.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të parashtruar nga ankuesi Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me datë; 26.01.2025 e mohon shkeljen e pretenduar dhe thekson se pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme duke potencuar se objekti/lokali në të cilin janë vendosur posterat është pronë e investitorit Riza Malaj dhe si i tillë nuk përbën hapësirë publike pasi që posterat janë vendosur në xhamat e lokalit dhe jo në murin e jashtëm të ndërtesës së banimit kolektiv siç pretendohet në ankesë, duke shtuar se kandidati Xhevahir Geci ka siguruar pëlqimin nga pronari i lokalit për vendosjen e banerëve-posterëve me këtë rast edhe ka bashkangjitur pëlqimin me shkrim të dhënë nga Riza Malaj.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjen se ankesa nuk është e bazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, sa i përket pretendimeve të parashtruesit se janë vendosur postera në hapësirë publike, konkretisht në ndërtesë të banimit kolektiv, në Rrugën “18 Qershori” të kandidatit për deputet Xhevahir Geci, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për Panelin këto pretendime janë të pabazuara dhe nuk mund të merret se kandidati i subjektit politik PDK ka shkelur nenin 34, pika 1 nënpar. 1.2 të LZP-në.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*,

Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.173/2025, datë 26.01.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.